



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.20/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli – kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi- anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së [REDAKTUAR] nga Istogu, me vendbanim në Berlin - Gjermani, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3698-2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZP.Anr.20/2025 e datës 13.12.2025 parashtruar nga [REDAKTUAR], nga Istogu, me vendbanim në Berlin - Gjermani të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3698-2025, të datës 08.12.2025, për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 13.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Istogu, me vendbanim në Berlin – Gjermani, me të cilën pretendon se ka bërë kërkesën për regjistrim nga Diaspora për Votim më 28.12.2025, çka është pranuar në bazë të kriterëve të parashtruara nga KQZ. Ka marrë kodin, plotësuar të gjitha kërkesat online më 06.12.2025 pas 24 orëve, me 07.12.2025 vjen emaili kundërshtues gjoja mungon foto me letërnjoftim në dorë, me kusht që përsëri ta përsërisë brenda datës 07.12.2025, gjë që e ka kryer dhe ka dërguar me devotshmëri, pastaj pason një vendim kundërshtues i përgjithshëm me emrat e të gjithë personave që ju është refuzuar regjistrimi ku është emri i tij. Të njëjtin vendim e ka kundërshtuar dhe në ankesë si dëshmi ka bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin me foto.

Në përgjigjen në ankesë dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve-KQZ, me datë 14.12.2025, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën ton, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: KQZ, më datën 08.12.2025, me vendimin Nr. 01/3698/2025, ka miratuar rekomandimin për refuzimin e kundërshtimit administrativ, palët

janë udhëzuar përmes këshillës juridike, që kanë të drejtë ankesë në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i pranimit të vendimit. Andaj, ankesa e palës ankuese është jashtë afatit të përcaktuar në vendim. Për më tepër, KQZ, me vendimin e datës 10.12.2025, Nr.01/3787/2025, ka Certifikuar Listën Votuese, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Shtetasi z. [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR], ka aplikuar përmes platformës elektronike. Arsyet e refuzimit të aplikimit të palës ankuese janë : mungon fotografia me dokumentet identifikuese të Kosovës në dorë, ashtu siç përcaktohet më nën paragrafin 4.5 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku thuhet *“bënë verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit përmes identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij/saj dhe mbanë në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës, apo përmes skanimit biometrik me njohje të fytyrës”*.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjen se:

- Ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se vendimi i KQZ-së, me nr. protokoli 01/3698-2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, lidhur me mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës, janë të pabazuara.

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vendimin nr. protokoli 01/3698-2025, të datës 08.12.2025 të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas nenit 3 nënparagrafin 4.5 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin nen të njëjtës Rregullore ndër të tjera thuhet se *“4.Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1.Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2.Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3.fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4.fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1; 4.5.bën verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij/saj dhe mbanë në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës, apo përmes skanimit biometrik me njohje të fytyrës.”*

Nga shkresat e lëndës, ankesës si dhe nga përgjigja e KQZ-se, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformës

elektronike të KQZ-së, pavarësisht faktit që aplikuesi kishte bashkangjitur disa dokumente të kërkuara, ai nuk ka plotësuar një nga kriteret e rëndësishme-vendimtare bërjen e verifikimit të dyfishtë të identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij dhe mbanë në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës, apo përmes skanimit biometrik me njohje të fytyrës, në kundërshtim me nënparagrafin 4.5 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 “Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës”, ku kërkohet që aplikuesi të dërgojë foton e tij duke mbajtur në dorë dokumentin identifikues të tij. Në aplikimin e tij, parashtruesi i ankesës kishte bashkangjitur letërnjoftimin si dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës. Megjithatë, përveç këtyre dokumenteve, sipas procedurave të KQZ-së, kërkohet verifikim që aplikuesi të bëjë verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij dhe mbanë në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës. Në rastin konkret, aplikuesi gjatë aplikimit nuk e ka plotësuar kërkesën për regjistrim jashtë Kosovës për kriteret e vendosura sipas KQZ-së dhe kjo ka rezultuar në mos plotësimin e kriterëve të rregulluara me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së. Lidhur me pretendimin se ankuesi ka përsërit veprimin dhe ka dërguar me datë 07.12.2025, një pretendim i tillë është i pa bazuar nga se ankuesi nuk ka paraqitur provat që kërkohen si më lartë, përkatësisht me mbështet pretendimet ankimore nga se fotot e skanuara me ankesë janë bërë pas miratimit të rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ dhe nuk ka mbajtur në dorë dokumentin e identifikimit të tij, në mënyrë që të shihet fytyra e tij në kohë reale gjatë aplikimit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3 nënparagrafin 4.5 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës, neni 10 paragrafi 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.20/2025, datë 16.12.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.